

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

PRIMUS ALBANIA

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L42202028V

NUIS/NIPT

Rruga Margarita Tutulani, pallati Viridario 1

Adresa

Tiranë

Albania

1000

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0697073123

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@primus.com.al

E-mail

Administrator Hrvoje Cabrajic

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/01/11

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355697073123

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-92678-12-29-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

144333300

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/02/05

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Shërbime

Data e zhvillimit të procedurës

2024/01/03

Numri i njoftimit

CN/24791/12292023

Kodi CPV

48444100-3 - Sistem faturimi, 50312300-8 -

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij
Dokumentet Standarte të Tenderit

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Në datë 03.01.2024 identifikua në SEP të APP publikimin e procedurës së prokurimit nr. REF-92678-12-29-2023 me objekt prokurimi “Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”, me fond limit 144.333.300 lek publikuar nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh. A. Afati i dorëzimit të ofertave është data 05.02.2024, ora 10:00.

Duke identifikuar parregullsi në dokumentet e tenderit (DST), po kërkojmë sipas rastit heqjen/riformulimin/modifikimin e tyre.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

A. Në Njoftimin e Kontratës, pika 2,2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP), keni sqaruar si më poshtë:

? Sistem faturimi 48444100-3

? Mirembajtje dhe riparim i pajisjeve të rrjetit të dhënave 50312300-8

? Mirembajtje dhe riparim i pajisjeve të teknologjive të informacionit 50312600-1

Referuar objektit të kontratës “Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”, shtojcës 5 Formulari i Specifikimeve Teknike pika 2.3 Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Kontraktori, si më poshtë:

2.3. Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Kontraktori

? Përmirësimi i mëtejshëm i Sistemit të Faturimit AI-Billing dhe përshtatja me kërkesat e UKT

? Përmirësimi i modulit të administrimit të abonentëve duke mundësuar kontrollet e nevojshme si dhe shtuar informacionin e nevojshëm

? Përmirësimi i modulit të administrimit të tatifave, duke e sjellë në linjë me administrimin e saktë të tarifave dhe taksave

? Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e mundësive të pagesave pjesore apo atyre kreditore

? Përmirësimi dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët)

? Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e dashboard-eve me analiza grafike lidhur me faturimin, arkëtimin, leximet dhe përdoruesit aktiv

? Përmirësimi i sistemit të faturimit duke mundësuar analizimin e menjëhershëm të planit të faturimit me faturimin mujor

? Përmirësimi i Modulit të Faturës Online duke reflektuar të gjithë ndryshimet e faturës apo ndryshimeve tek abonenti

? Saktësimin e të dhënave Online edhe për ankesë/kërkesat apo shfaqjen e plotë të të gjithë të dhënave të abonentëve

? Përmirësimi i sistemit të faturimit AI-Billing referuar administrimit të plotë të Akt-Marrveshjeve duke mundësuar më shumë se një akt-marrveshje, analizën automatike të tyre lidhur me respektimin dhe lejuar pagesat e kësteve duke i reflektuar ato saktë në raporte

- ? Mundësimi i transferimit të të dhënave të faturimit dhe arkëtimeve në sistemin Microsoft Dynamics NAV (përcaktimet e fushave do të bëhen gjatë fazës së integritimit)
- ? Shtimin e opsioneve për anulimi i taksave që të realizohen pa prekur kunsumin e ujit dhe ky proces të mund të bëhet nëpërmjet dhënies së të drejtës Drejtorisë së Taksave
- ? Përmirësimi i modulit të raportimit dinamik duke lejuar IT në nivel përdoruesi aplikimi të krijojnë raportet e nevojshme
- ? Krijimin e evidencave që pasqyron faturimin e taksave vendore të cdo muaji të ndarë për secilen taksë dhe njësi/zonë
- ? Krijimin e evidencës që pasqyron faturimin e kamatës progresive ditore dhe mujore
- ? Krijimin e evidencës që pasqyron faturimin e vlerës së rilidhjes
- ? Pasqyrimi i faturës së gjobës në SMI dhe rishikimi i procesit
- ? Krijimin e evidencës mujore që të përfshijë zërat e ndarë në nr. abonentesh, konsum ne m3, vlerë konsumi uji në lekë, tarifë dhe taksa vendore
- ? Shtimi i zërave tek raporti arkëtime ditore debitore sic janë të ndarë zërat tëk evidenca e arketimeve të grupuara
- ? Implementimi i sistemit të auditimit të bazave të të dhënave Oracle si core audit application
- ? Implementimi i mjeteve të avancuara të raportimit të tipit Business Intelligence, si dhe lidhjen me bazën e të dhënave të AL-Billing për mundësimin e operatoreve dhe përdoruesve të sistemit të pavarisish në ndërtimin e raportimeve të reja.
- ? Shtimi i sigurisë së aksesimit të sistemit nga përdoruesit duke propozuar politikat e sigurisë së fjalëkalimit (kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti i ndryshimit) dhe implementuar jo vetëm ndryshimin e detyruar të fjalëkalimit por edhe duke shtuar 2FA
- ? Krijimi i një ambjenti për operimit të moduleve web service të komunikimit të sistemit AL-Billing online. Shkembimi i informacionit që lidhet me pagesën e faturave të realizuara në Banka.
- ? Përditesimi dhe aplikimi i modifikimeve të lidhura me zhvillimet
- ? Ruajtja e historikut të ndryshimeve të leximeve, faturimeve dhe arkëtimeve
- ? Parapërgatitja e rregulloreve për përdorimin e sistemit
- ? Parapërgatitja e rregulloreve operacionale për veprimet sistemuese duke saktësuar të gjithë veprimet dhe mënyrën e sistemit duke mundësuar realizimin e tyre nga aplikimi e jo në bazën e të dhënave
- ? Përpilimin e dokumentit për të gjithë diagramën e qarkullimit të informacionit nëpërmjet sistemeve dhe moduleve
- ? Parapërgatitja e dokumentacionit të dokumentimit të bazë së të dhënave me detajet dhe elementët teknik të përfshira
- ? Parapërgatitja e rregullores për administrimin e përdoruesve dhe ripërcaktimi i roleve dhe të drejtave duke saktësuar edhe format e të drejtave referuar rregullores.
- ? Trajnimin e IT për zhvillim dhe përshtatje të sistemit si dhe listës të shërbimeve nuk rezultojnë që të jenë kërkuar shërbime “Mirembajtje dhe riparim i pajisjeve të rrjetit të të dhënave” dhe “Mirembajtje dhe riparim i pajisjeve të teknologjise se informacionit”. Duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në përgatitjen e ofertës por kryesisht në hartimin dhe më pas zbatimin e një kontrate të mundshme, kërkojmë korigjimin apo heqjen e kësaj të dhëne nga DST.

B. Në shtojcën 5 Formulari i Specifikimeve Teknike pika 2.3 Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Kontraktori, ndër të tjera keni kërkuar edhe shërbimin për Trajnimin e IT për zhvillim dhe përshtatje të sistemit, si më poshtë:

2.3. Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Kontraktori

- ? Përmirësimi i mëtejshëm i Sistemit të Faturimit Al-Billing dhe përshtatja me kërkesat e UKT
- ? Përmirësimi i modulit të administrimit të abonentëve duke mundësuar kontrollet e nevojshme si dhe shtuar informacionin e nevojshëm
- ? Përmirësimi i modulit të administrimit të tatifave, duke e sjellë në linjë me administrimin e saktë të tarifave dhe taksave
- ? Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e mundësive të pagesave pjesore apo atyre kreditore
- ? Përmirësimi dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët)
- ? Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e dashboard-eve me analiza grafike lidhur me faturimin, arkëtimin, leximet dhe përdoruesit aktiv
- ? Përmirësimi i sistemit të faturimit duke mundësuar analizimin e menjëhershëm të planit të faturimit me faturimin mujor
- ? Përmirësimi i Modulit të Faturës Online duke reflektuar të gjithë ndryshimet e faturës apo ndryshimeve tek abonenti
- ? Saktësimin e të dhënave Online edhe për ankesë/kërkesat apo shfaqjen e plotë të të gjithë të dhënave të abonentëve
- ? Përmirësimi i sistemit të faturimit Al-Billing referuar administrimit të plotë të Akt-Marrveshjeve duke mundësuar më shumë se një akt-marrveshje, analizën automatike të tyre lidhur me respektimin dhe lejuar pagesat e kësteve duke i reflektuar ato saktë në raporte
- ? Mundësimi i transferimit të të dhënave të faturimit dhe arkëtimeve në sistemin Microsoft Dynamics NAV (përcaktimet e fushave do të bëhen gjatë fazës së integritimit)
- ? Shtimin e opsioneve për anulimi i taksave që të realizohen pa prekur konsumin e ujit dhe ky proces të mund të bëhet nëpërmjet dhënies së të drejtës Drejtorisë së Taksave
- ? Përmirësimi i modulit të raportimit dinamik duke lejuar IT në nivel përdoruesi aplikimi të krijojë raportet e nevojshme
- ? Krijimin e evidencave që pasqyron faturimin e taksave vendore të cdo muaji të ndarë për secilen taksë dhe njësi/zonë
- ? Krijimin e evidencës që pasqyron faturimin e kamatës progresive ditore dhe mujore
- ? Krijimin e evidencës që pasqyron faturimin e vlerës së rilidhjes
- ? Pasqyrimi i faturës së gjobës në SMI dhe rishikimi i procesit
- ? Krijimin e evidencës mujore që të përfshijë zërat e ndarë në nr. abonentesh, konsum ne m3, vlerë konsumi uji në lekë, tarifë dhe taksa vendore
- ? Shtimi i zërave tek raporti arkëtime ditore debitore sic janë të ndarë zërat të evidencave e arkëtimeve të grupuara
- ? Implementim i sistemit të auditimit të bazave të të dhënave Oracle si core audit application
- ? Implementimi i mjeteve të avancuara të raportimit të tipit Business Intelligence, si dhe lidhjen me bazën e të dhënave të AL-Billing për mundësimin e operatoreve dhe përdoruesve të sistemit të pavarësisë në ndërtimin e raportimeve të reja.
- ? Shtimi i sigurisë së aksesimit të sistemit nga përdoruesit duke propozuar politikën e sigurisë së fjalëkalimit (kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti i ndryshimit) dhe implementuar jo vetëm ndryshimin e detyruar të fjalëkalimit por edhe duke shtuar 2FA
- ? Krijimi i një ambjenti për operimin të moduleve web service të komunikimit të sistemit AL-Billing online. Shkembimi i informacionit që lidhet me pagesën e faturave të realizuara në Banka.
- ? Përditesimi dhe aplikimi i modifikimeve të lidhura me zhvillimet
- ? Ruajtja e historikut të ndryshimeve të leximeve, faturimeve dhe arkëtimeve
- ? Parapërgatitja e rregulloreve për përdorimin e sistemit

? Parapërgatitja e rregulloreve operacionale për veprimet sistemuese duke saktësuar të gjithë veprimet dhe mënyrën e sistemit duke mundësuar realizimin e tyre nga aplikimi e jo në bazën e të dhënave

? Përpilimin e dokumentit për të gjithë diagramën e qarkullimit të informacionit nëpërmjet sistemeve dhe moduleve

? Parapërgatitja e dokumentacionit të dokumentimit të bazë së të dhënave me detajet dhe elementët teknik të përfshira

? Parapërgatitja e rregullores për administrimin e përdoruesve dhe ripërcaktimi i roleve dhe të drejtave duke saktësuar edhe format e të drejtave referuar rregullores.

? Trajnimin e IT për zhvillim dhe përshtatje të sistemit

Ndërkaq në shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, si më poshtë, nuk keni listuar dhe nuk keni dhënë të dhëna konkrete për zërin e shërbimit Trajnimin e IT për zhvillim dhe përshtatje të sistemit, i cili kërkon afatin e duhur dhe shoqërohet me koston përkatëse.

Duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në planifikimin e angazhimit të burimeve njerëzore dhe në përgatitjen e ofertës, kërkojmë sqarimin/plotësimin e kësaj të dhëne të rëndësishme.

C. Në Njoftimi i Shkurtuar i Kontratës, keni përcaktuar në pikën 7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 36 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në shtojcën 5. Formulari i Specifikimeve Teknike, në tabelën e zërave të shërbimeve keni përcaktuar të tjera afate maksimale të realizimit të kontratës duke nisur nga data e nënshkrimit të saj.

Edhe në shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit keni përcaktuar të tjera afate maksimale të realizimit të kontratës duke nisur nga data e nënshkrimit të saj.

Nisur nga këto të dhëna të ndryshme, krijohet konfuzion dhe paqartësi në përcaktimin e afatit të saktë maksimal të shërbimeve të kërkuara, nëse është 6 muaj nga nënshkrimi i kontratës apo është 36 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në planifikimin e angazhimit të burimeve njerëzore dhe në përgatitjen e saktë të ofertës, kërkojmë sqarimin/plotësimin e kësaj të dhëne të rëndësishme.

D. Në shtojcën 5. Formulari i Specifikimeve Teknike, tabela 1 keni përcaktuar shërbimin me numër rendor 2 dhe shënimin në vijim të tij si më poshtë:

Shënim (*): Plani i lidhjes per secilen nga Bankat, do te kryhet pergjate periudhes se mirembajtjes se sistemeve. Grupit te punes se UKT qe do te ndjek zbatimin te projektit, dhe koordinimin me Bankat per realizimin e lidhjeve. Plani i integritimeve, do te percaktohet nga UKT dhe OE do te njoftohet paraprakisht (per te lejuar pregatitjen e personelit te OE) te pakten dy jave para cdo fillim integrimi.

Në tabelën e zërave në kolonën me numrin rendor 2 është kërkuar “Përmirësimi dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (web service) me palët e treta. Lidhja me 1 nga Bankat (*)”.

Pra kërkohet lidhja vetëm me një nga bankat, ndërkohë që në shënimin e sqarimit për numrin rendor 2 është kërkuar “Plani i lidhjes per secilen nga Bankat, do te kryhet pergjate periudhes se mirembajtjes se sistemeve?”. Pra, për secilën nga bankat që nëkupton disa banka dhe jo vetëm një bankë. Në këtë rast nuk është e qartë nëse ky shërbim kërkohet për vetëm një bankë të nivelit të dytë apo për disa nga bankat e nivelit të dytë, Nëse janë disa banka atëherë sa është numri i tyre. Duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në planifikimin e angazhimit të burimeve njerëzore dhe në përgatitjen e saktë të ofertës, kërkojmë sqarimin/plotësimin e kësaj të dhëne të rëndësishme.

E. Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.2.4 keni kërkuar si më poshtë:

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Paragrafi i parë i kriterit 2.2.4 është i paqartë dhe krijon konfuzion për plotësimin e tij. Çfarë konkretisht kërkohet nga çdo anëtar i grupit dhe kush është vërtetimi i lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin ai është regjistruar sipas QKB?

Edhe vijimi i këtij kriteri me paragrafet 2, 3 dhe 4, të cilët duken pa lidhje me paragrafin 1, e thellojnë paqartësinë dhe konfuzionin në kuptimin e më pas plotësimin e këtij kriteri.

Përsa më sipër kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin/qartësimin apo heqjen e këtij kriteri.

F. Në shtojca 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.6 keni kërkuar si më poshtë:

2.6 Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë çertifikimet, kualifikimet si me poshte:

? Infrastructure Cloud;

? Sisteme bazash të dhenash Cloud;

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, ose certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

Në formulim duket sikur është kërkuar që certifikimet, kualifikimet të jenë në nivel të operatorit ekonomik. Termi “kualifikim” për një operator ekonomik (subjekt) nuk qëndron. Kualifikimet përgjithësisht i referohen individëve, punonjësve, siç janë dhe dy certifikimet, kualifikimet e kërkuara në rastin konkret.

Përsa më sipër, duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në përmbushjen e këtij kriteri, kërkojmë korigjimin e formulimit të këtij kriteri.

G. Në shtojca 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.7 në versionet shqip dhe anglisht të DST keni kërkuar respektivisht si më poshtë:

2.7. Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontrates, që do të angazhohet në implementimin e projektit, duke pasur njohuri të kombinuara sipas kërkesave të mëposhtme:

? 2 (dy) punonjës të certifikuar për sistemin ORACLE;

2.7. The economic operator must have, at least the last 3 (three) months from the date of publication of the contract notice, technical personnel, who will engage in the implementation of the project, having combined knowledge according to the following criteria:

? 2 (two) employees certified for AL-Billing system or equivalent;

Versionet në shqip dhe anglisht të kësaj kërkesë nuk përputhen.

Përsa më sipër kërkojmë ndërhyrjen tuaj për saktësimin e kësaj kërkesë nëse kërkohen punonjës të çertifikuar për sistemin Oracle apo të çertifikuar për sistemin e faturimit Al-Billing.

H. Në Njoftimi i Kontratës, pika 4.7, në dy versionet shqip dhe anglisht të DST keni për zgjedhur si më poshtë:

Njoftimi i Kontratës

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip Anglisht

Contract Notice

4.7 Language(s) in which Bids may be drawn up:

Albanian English

Eshtë pranuar që ofertat mund të hartohen/paraqiten në shqip dhe anglisht.

Ju lutemi sqaroni nëse oferta duhet të jetë në njërin nga dy gjuhët e sipërcituara apo oferta mund të jetë e kombinuar në gjuhët shqip dhe anglisht.

Ndërkohë në shtojca 8 Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.7 në versionet shqip dhe anglisht të DST keni kërkuar respektivisht si më poshtë:

2.7. Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të angazhohet në implementimin e projektit, duke pasur njohuri të kombinuar sipas kërkesave të mëposhtme:

? 1 (një) punonjës të certifikuar për zbatime sistemesh ERP

? 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme infrastrukture cloud

? 1 (një) punonjës të certifikuar për raportim të tipit BI

? 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator e bazës së të dhënave

? 2 (dy) punonjës të certifikuar për sistemin ORACLE ;

? 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim në web/mobile;

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Kontratën e punës

b. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2.7. The economic operator must have, at least the last 3 (three) months from the date of publication of the contract notice, technical personnel, who will engage in the implementation of the project, having combined knowledge according to the following criteria:

? 1 (one) certified employee for ERP systems implementation

? 1 (one) employee certified for cloud infrastructure systems

? 1 (one) employee certified for BI type reporting

? 1 (one) certified employee for database administrator

? 2 (two) employees certified for AL-Billing system or equivalent;

? 2 (two) employees certified for web/mobile development;

An employee may hold more than one attestation.

To prove the fulfillment of this criterion, economic operators must submit the following documentation for the above-mentioned employees:

a. The employment agreement

b. Relevant certificates. In case the certificates are in a foreign language, the economic operator must present them translated according to the applicable legal provisions in force.

Nëse oferta pranohet në gjuhën anglisht atëherë përse në të dy versionet e publikuara të DST (shqip dhe anglisht) kërkohet si më poshtë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

b. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

To prove the fulfillment of this criterion, economic operators must submit the following documentation for the above-mentioned employees:

b. Relevant certificates. In case the certificates are in a foreign language, the economic operator must present them translated according to the applicable legal provisions in force.

Në këtë rast gjuha e huaj nuk nënkupton gjuhën angleze (mqs oferta në anglisht është e pranuar) dhe përkthimi sipas dispozitave ligjore në fuqi nënkupton përkthimin në gjuhën shqipe apo angleze (mqs oferta në anglisht është e pranuar)?

Përsa më sipër, duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në gjuhën e përgatitjes së ofertës, kërkohet sqarimin/korigjimin e kësaj të dhëne/kërkese.

I. Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.8 keni kërkuar si më poshtë:

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një oferte teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në:

? Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik);

? Konfirmimin e realizimit të lidhjes për shkëmbimin e pagesave në një nga Bankat.

? Përgjigje për çdo kërkesë teknike të specifikuar në Termat e Referencës të sistemit.

Shënim: Përgjigje copy-paste të kërkesave nuk do të pranohen.

Kjo kërkesë nuk është shoqëruar me kujtesën që ky kriter në këtë fazë plotësohet nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit.

Shtojca 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ndër të tjera shprehet si më poshtë:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës.

Pra, me anë të formularit të vetëdeklarimit operatori ekonomik do të deklarojë plotësimin e specifikimeve teknike (nënkupto ofertën teknike) në fazën e ofertimit elektronik të ofertave dhe kjo kërkesë pika 2.8 është në tejkalim të ligjit në këtë fazë ofertimi.

Duke e konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në momentin e postimit të ofertës elektronike, kërkohet saktësimin/plotësimin e këtij kriteri me kujtesën e përmbushjes të këtij kriteri me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit në fazën e ofertimit elektronik të ofertave.

J. Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.8 keni kërkuar si më poshtë:

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një oferte teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në:

? Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik);

Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i disa shërbimeve në fushën e IT (përmirësime të programeve kompjuterike, ofrimi i web service, licenca programesh, mirëmbajtje programesh kompjuterike, etj.) ndërkohë kërkohen materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik) që përgjithësisht i referohen dhe nënkuptojnë mallra/pajisje.

Duke e konsideruar të paqartë, jo në përputhje me shërbimet e kërkuara dhe që krijon konfuzion në përgatitjen e ofertës por edhe në vlerësimin e saj, kërkohet heqjen e kësaj kërkese.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Sipas percaktimeve ligjore

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@primus.com.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Hrvoje Cabrajic